

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN VLLAHINË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën e Vllahinës, Vlorë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 68, datë 03.06.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 242/6, datë 03.06.2015, i ka rekomanduar z. , Kryetar i komunës Vllahinë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e dërguara nga KLSH me shkresën nr. 495/4 prot., datë 20.04.2011, për 6 masa “Shpërblim dëmi” në vlerë **1,687,405 lekë**. Komuna Vllahinë deri në momentin e auditimit është mjaftuar vetëm me lëshimin e urdhrave nga nëpunësi autorizues, por nuk ka ndjekur procedurat administrative dhe ligjore në organet kompetente .

1.1. Rekomandim: Komuna Vllahinë të marrë masa dhe të nxjerrë aktet administrative përkatëse, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,687,405 lekë**, detyrime nga zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 495/4 prot., datë 20.04.2011, në lidhje me kërkesat për shpërblim dëmi.

Menjëherë

2. Gjetja nga auditimi: Komuna Vllahinë, nuk ka hartuar politikat në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë publike që drejton, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

2.1. Rekomandim: Komuna Vllahinë të marrë masa duke hartuar politikat në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë publike, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

Në Vijimësi

3. Gjetja nga auditimi: Nuk është miratuar sistemi i rregullave specifike dhe procedurave për administrimin, ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas kërkesave të përcaktuara në Kap. III të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3.1.Rekomandim: Komuna Vllahinë të marrë masa dhe të miratojë një sistem të rregullave specifike të procedurave për administrimin, ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike sipas kërkesave ligjore.

Në Vijimësi

4. Gjetja nga auditimi: Nëpunësi zbatues i komunës, nuk ka bërë përcaktimin e gjendjes së vlerave monetare në arkë me anë të inventarizimit fizik një herë në muaj, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Menaxhimi i aktiveve në sektorin publik” pika 80, “Përcaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlerë, bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj”

4.1. Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të bëjë përcaktimin e gjendjes së vlerave monetare në arkë me anë të inventarizimeve periodike një herë në muaj, sipas kërkesave ligjore e nënligjore.

Në Vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

-Në hartimin e Programit Afat Mesëm për periudhën 2013-2015, nuk janë programuar të ardhurat nga taksat dhe tarifat.

-Komuna Vllahinë nuk ka zbatuar procedurat lidhur me përgatitjen dhe hartimin e projekt buxheteve, në përmbushje të të gjithë funksioneve, ku të sigurohet një evidentim i saktë,

vlerësim e zbatim i njëjtë i buxhetit vendor dhe qendror, sipas kërkesave ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e vitit 2013”, ligjit nr. 185/2013 “Për Buxhetin e vitit 2014”. Kjo, për arsye se në programimin e shpenzimeve për vitin ushtrimor, nuk janë përfshirë detyrimet afat shkurtra ndaj të tretëve, të rezultuara nga mbyllja e vitit të mëparshëm, në kundërshtim me paragrafin 101, të Udhëzimit nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

- Në programimin e shpenzimeve për vitin ushtrimor, nuk janë përfshirë detyrimet afat shkurtra ndaj të tretëve, të rezultuara nga mbyllja e vitit të mëparshëm, në kundërshtim me udhëzimin nr. 2 datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

5.1. Rekomandim:

-Komuna Vllahinë të hartojë një strategji të zhvillimit ekonomik dhe sektorial, duke ngritur ekipet përkatëse të menaxhimit, si dhe të marrë në konsideratë dokumentet në hartimin e PBA-së.

-Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, Menaxhimit të Tokës dhe Shërbimeve, gjatë përgatitjes së projektbuxhetit korrent dhe projektbuxhetit afatmesëm, të parashikojnë detyrimet afatshkurta ndaj të tretëve dhe kërkesat për arkëtim mbi debitorët.

- Të ngrihet ekipi i menaxhimit të programit, i cili është përgjegjës për nxjerrjen e një plani të hollësishëm për tre vitet e procesit planifikues buxhetor afatmesëm që përputhet me prioritetet e politikave dhe i përballeshëm brenda tavanit, për monitorimin e ecurisë gjatë vitit ushtrimor.

- Në hartimin e Projekt Buxheteve Afatmesme të mbahen parasysh inkurajimi i efektivitetit, eficences dhe ekonomicitetit në kryerjen e shpenzimeve, të ketë lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjike me shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, promovimin e disiplinës fiskale, duke mundësuar që shpenzimet të planifikohen brenda nevojave të komunitetit.

Në Vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare, me përjashtim të çështjeve të theksuar më poshtë:

-Në pasqyrat financiare (bilanceve kontabël) të viteve 2013-2014, nuk janë saktësuar sipas analizave aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, në mbështetje të inventarizimit fizik në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Drejtoria Ekonomike nuk ka marrë masa për informatizimin e veprimeve me magazinimin, me qëllim që të ndiqet gjurma e konsumit apo e amortizimit.

-Drejtoria Ekonomike nuk ka parashikuar likuidimin e faturave për investimet e kryera dhe të marra në dorëzim, si dhe shpenzimet operative të prapambetura, në zbatim të kërkesave të UMF “Për zbatimin e buxhetit të viteve 2013-2014”.

-Komuna Vllahinë nuk ka kryer investime në IT, për programe në fushën e administrimit financiar etj. për rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM Nr. 25 datë 20.01.2001.

- Komuna nuk ka marrë masa për rillogaritjen e planit të të ardhurave, mbasi ka rezerva në planifikim dhe ta paraqesë në këshillin e komunës, konform ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore”.

-Njësia nuk ka krijuar regjistrin e aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si, data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nga auditimi konstatohet se, me gjithë punën e bërë nga komuna jo të gjitha objektet që janë regjistruar në postin “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, janë regjistruar në Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas kërkesave të ligjit.

Pavarësisht se nga ana formale llogaria e vitit 2013, është paraqitur e protokolluar në Degën e Thesarit Vlorë, në to reflektohet cilësi e dobët e mos përgjegjësi në rakordimin e postave e rubrikave të Pasqyrave Financiare me informacionin kontabël.

-Mosfunksionim të sistemit të kontabilitetit, në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, për arsye se, nuk kanë mbajtur librat e kontabilitetit si: Ditari i arkës, bankës, magazinës, libri i magazinës dhe libri i madh, për të verifikuar saktësinë e tepricave të llogarive të pasqyruara në bilancin ose llogarinë vjetore të vitit ushtrimor 2013, 2014.

-Veprimet nga arkëtimi i të ardhurave nga uji i pijshëm në fshatrat Vllahinë, Kocul dhe Peshkëpi bëhet nga faturistët në terren, të cilët mbajnë vlerat monetare për një periudhë të pacaktuar kohe pa i derdhur në arkën e komunës, duke bërë që të mungojë plotësisht sistemi i kontrollit të brendshëm në këtë veprimtari, për arsye se:

a-Listat e detyrimeve të ujit të pijshëm hartohen nga faturistët, nuk nënshkruhen nga nëpunësi zbatues dhe autorizues.

b- Nuk kontabilizohen detyrimet mujore dhe progresive për çdo familje (detyrimet mbahen ekstrakontabile)

c-Nuk kontabilizohet arkëtimi i lekëve nga familjarët (tek faturistët) duke i zbritur debinë përkatëse.

- Nëpunësi zbatues dhe autorizues nuk kanë marrë masa konkrete, për të koordinuar punën me strukturat përkatëse në komunë për përmirësimin e dokumentacionit, me qëllim evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme në rrugë administrative, gjyqësore e përmbarimore të debitorëve (të cilët mbahen jashtë kontabilitetit), si dhe për arkëtimin e këtyre vlerave në komunën Vllahinë .

6.1. Rekomandim:

Drejtoria Ekonomike e Komunës Vllahinë:

- Të përgatitë një dokument ku të përshkruajë organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditit në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”,

- Të saktësojë sipas analizave aktivitetet e qëndrueshme të trupëzuara, në mbështetje të inventarizimit kontabël dhe fizik, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Të marrë masa për informatizimin në fushën e administrimit financiar, për rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar, me qëllim që të ndiqet gjurma e konsumit apo e amortizimit të aktiveve, konform VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.

-Të zbatohet metoda e shpenzimeve dhe të ardhurave, e cila ka të bëjë me njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës konform ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”.

Në Vijimësi

7. Gjetjet nga auditimi: Nuk është bërë planifikimi i studiuar i të ardhurave vendore, nuk janë hartuar plane pune për ushtrimin e kontrolleve në subjekt, si dhe nuk janë njoftuar subjektet lidhur me shlyerjen e detyrimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9236, datë 30.10.2006 “Për taksat dhe tatimet vendore”.

7.1. Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për:

a) Planifikimin real të taksave e tarifave vendore, bazuar në të dhënat që disponon Komuna dhe realizimeve të mëparshme, duke i programuar ato analitikisht, në mënyrë që niveli i planifikimit të tyre të vijë në rritje nga njëra periudhë në tjetrën.

b) Hartimin e planeve mujore dhe vjetore për ushtrimin e kontrolleve në përputhje me pikën 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit të përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 06.02.2007.

c) Njoftimin e të gjithë abonentëve familjarë dhe jo familjarë, mbi detyrimet që ato kanë për taksat/tarifat vendore në zbatim të nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

Në Vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nuk janë kryer inventarizimet e dosjeve të subjekteve, që ushtrojnë aktivitet në Komunën Vllahinë, duke i përditësuar dhe plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm si: Njoftim Vlerësimi Tatimor dhe Dokumenti i Pagesës së Detyrimit, Lejet e dhëna nga QKR për ushtrimin e aktivitetit, Certifikatat, Dokumentet e blerjes së kasës fiskale, Deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, Genplanet apo planimetritë për taksën e ndërtesave për familjarët, Akt-konstatimet apo Akt-verifikimet për rivlerësimin tatimor, për ndërprerjet e përkohshme ose mbylljet e aktivitetit, në kundërshtim me nenin 29 “Dosja e detyrimeve tatimore”, pika 1, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

8.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Tatim Taksave të kryejë inventarizimin e dosjeve të të gjitha subjekteve, që ushtrojnë aktivitet në komunën Vllahinë, duke i përditësuar dhe plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës dhe Sektori i Taksave e Tarifave Vendore nuk kanë evidentuar debitorët nga taksat dhe tarifat si dhe nuk kanë kryer regjistrimin e tyre në pasqyrat financiare të komunës në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Nga mos arkëtimi i detyrimeve deri më datë 31.12.2014 janë krijuar debitorë **në vlerën 79,420,147 lekë**.

9.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Taksave e Tarifave, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara deri më datën 31.12.2014 në vlerën **79,420,147 lekë**, përkatësisht: tatimin mbi tokën bujqësore në vlerën 69,265,407 lekë dhe taksën e biznesit të vogël në vlerën 10,154,740 lekë.

Deri më datë 31.12.2015

10. Gjetje nga auditimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka bërë përpjekjet e duhura për të kontraktuar me agentët tatimor të përcaktuar me ligj si: ZVRPP, ALUIZNIN dhe DTR, Vlorë, por edhe për krijimin e agentëve të rinj lokal.

10.1. Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të kërkojë taksat e ndërtesave të banimit dhe tarifat e shërbimit për ndriçimin, pastrimin dhe gjelbërimin, si dhe të kontraktohen dhe kërkohej arkëtimi nga agentë të rinj lokal si KESH, duke nënshkruar marrëveshje të posaçme bashkëpunimi, ku të jenë përcaktuar të drejta dhe detyrime (sanksionet) për secilën palë, të cilat do të mund të sigurojnë rritjen e efektivitetit të zbatimit të ligjit dhe garantojnë realizimin e të ardhurave.

Në Vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Sektori i Tatim Taksave nuk ka aplikuar dënim me gjobë 5% në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit për taksën, për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

11.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Tatim-Taksave, në çdo rast të arkëtimit me vonesë të detyrimeve, të aplikojë dënim me gjobë nga 5% në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit për taksën, për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve, për subjektet të cilat nuk zbatojnë afatet e përcaktuara në dispozitën e cituar më sipër.

Në Vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Urbanistikës, Menaxhimit të Tokës dhe Shërbimeve, nuk ka zbatuar procedurat e aplikimit për regjistrimin në ZVRPP Vlorë të pasurive dhe Pronave të transferuara me VKM nr. 562, datë 07.08.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Komuna Vllahinë, Qarku Vlorë” dhe VKM Nr. 325, datë 16.05.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Vllahinë, në zbatim të neni 18, kreut IV të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, neni 18, “Dokumentacioni i transferimit” dhe me pikat 1, 2 të neni 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, për

rrjedhojë nuk janë pasqyruar në kontabilitet në përputhje me Kreu III neni 12, neni 18 pika 1 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe Pjesa I, pikat 2, 5, 6, 7, 8, 9, germa a, b, c, pikat 10, 12, 13. Pjesa III pikat 26, 28. Pjesa IV, pikat 73, 74, 75 Udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (Trajtuar më hollësisht në faqen 66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandim: Komuna Vllahinë të marrë masat dhe të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin në ZVRPP Vlorë, të pasurive dhe pronave të transferuara me VKM dhe pasi të ketë përfunduar regjistrimin e pasurive, të nisë inventarizimin fizik dhe përfshirjen e vlerës në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël për zërat: toka, troje, terrene, objekte të ndryshme duke i pasqyruar në Pasqyrat Financiare.

Deri më datë 31.12.2015

13. Gjetja nga auditimi: Strukturat përkatëse nuk kanë marrë me procesverbal sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor të transferuara në Komunën Vllahinë, mbi bazën e VKM nr. 562, datë 07.08.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njërive të qeverisjes vendore, Komuna Vllahinë, Qarku Vlorë”, nuk janë përcaktuar kategoritë dhe mungojnë hartat përkatëse, ku të përcaktohen kufijtë dhe plan vendosjet e tyre.

13.1. Rekomandim: Komuna Vllahinë të bashkëpunojë me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Qarku Vlorë dhe Ministrinë e Mjedisit, për pronat fond pyjor dhe kullor, që i janë transferuar komunës me VKM, të merren hartat përkatëse, të përcaktohen kategoritë dhe kufijtë, duke u shoqëruar me plan vendosjet e tyre dhe dokumentuar me procesverbal.

Në Vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Janë realizuar të ardhura minimale nga mos administrimi, menaxhimi dhe mbarështimi i ekonomive pyjore, kullorë dhe livadheve me efijence të resurseve të tyre, si: dhënia me qira e pyjeve, kullotave dhe livadheve, apo lëndë punimi a material drusor për përdorim a shitje për nevoja të komunitetit, si dhe të ardhura të realizuara nga përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës. Në vitin 2013 nga 886 ha kullota, janë dhënë me qira rreth 181 ha ose 20% e sipërfaqes, me impakt financiar negativ në të ardhura e komunës, për arsye se nuk janë dhënë me qira 80% e sipërfaqes në pronësi. Ndërsa në vitin 2014, nga 886 ha kullota janë dhënë me qira rreth 24 ha ose rreth 3% e sipërfaqes, me impakte financiare negative në të ardhura e komunës, për arsye se nuk janë dhënë me qira 97% të sipërfaqes në pronësi.

14.1. Rekomandim: Komuna Vllahinë, të marrë masat për hartimin e planit të menaxhimit dhe mbarështimit në pyje, kullota, livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen e gjahut dhe të shërbimeve çlodhëse, dhënien me qira të pronave të veta etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efijencë të plotë të këtyre resurseve.

Në Vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **9,763,802 lekë**. Konkretisht:

1. Gjetjet nga auditimi: Zyra e Financës nuk ka regjistruar në librat e kontabilitetit dhe nuk ka paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2013 dhe 2014, detyrimet e pa shlyera të ujit të pijshëm për fshatrat Vllahinë, Peshkëpi dhe Kocul **në vlerën 5,024,000 lekë**, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 783,

datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

1.1. Rekomandim: Dega Ekonomike në Komunën Vllahinë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **5,024,000 lekë**, pagesë e pa arkëtuar për konsumin e ujit të pijshëm nga familjet e fshatit Vllahinë, Peshkëpi dhe Kocul dhe ti pasqyrojë në dokumentet kontabël.

Deri më datë 30.09.2015

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, rezultojnë diferenca në volume pune të pakryera në **vlerën 3,868,615 lekë** pa T.V.SH, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar .

2.1. Rekomandim: Dega Ekonomike në Komunën Vllahinë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **3,868,615 lekë**, pa T.V.SH, nga operatori ekonomik “E...” shpk për punime të pa kryera në zbatimin e kontratës nr. 1008 prot., datë 09.11.2012 me objekt “Punime me ujësjellësin e Komunës Vllahinë”.

Deri më datë 30.09.2015

3. Gjetje nga auditimi: Komuna Vllahinë nuk ka nënshkruar kontrata qiraje me përdoruesit e pronës për periudhën përpara shitjes së apartamenteve, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet procedura dhe vlera e qirasë mujore për pronën publike, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 294,887 lekë**.

3.1. Rekomandim: Të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **294,887 lekë**, qira e pa paguar përkatësisht nga z. N.C, në vlerën 40,500 lekë, z. A.V në vlerën 90,337 lekë, z. F.M në vlerën 164,050 lekë.

Deri më datë 31.07.2015

4. Gjetje nga auditimi: Komuna Vllahinë, ka paguar 2 punonjës me pagë më të lartë se ajo e përcaktuar në pikat 18, 19 dhe 20/6 të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 216,000 lekë.

4.1. Rekomandim: Komuna Vllahinë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **216,000 lekë** nga dy punonjës sipas listës bashkëlidhur, paguar më tepër se sa përcaktohet në pikat 18, 19, 20/6 të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Deri më datë 31.12.2015

5. Gjetje nga auditimi: Komuna Vllahinë nuk ka arkëtuar vlerën 331,500 lekë nga 221 familje të taksës së përkohshme, për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfitueseve të tokës bujqësore të ish NB-ve, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Komunës, nr. 17, datë 29.05.2013 “Për miratimin e taksës së përkohshme për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfitueseve të tokës bujqësore të ish -NB-ve”, në të cilin është përcaktuar. që vlera e taksës së përkohshme të jetë 1500 lekë për çdo certifikatë.

5.1. Rekomandim: Të merren masa e të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **331,500 lekë**, taksë e kalimit në pronësi të përfitueseve të tokës bujqësore nga 187 familje në fshatin Vllahinë dhe 34 familje në fshatin Pete.

Deri më datë 31.07.2015

6. Gjetje nga auditimi: Nuk është nënshkruar kontratë qiraje për ambientet për vitin 2012, 2013, ndërmjet Komunës Vllahinë dhe z. A.I, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 28,800 lekë.

6.1. Rekomandim: Të merren masa e të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **28,800 lekë**, qira e pa paguar nga z. A.I.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 15, ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7; pikat, 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10 të kreut II-të dhe pikat 4, 5 të kreut III-të, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i propozohet: **Kryeinspektorit të Inspektoratit Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit (IMKT) pranë Komunës Vllahinë**, që të vlerësojë dhe të marrë masa administrative me gjobë për mbikëqyrësin e punimeve, si më poshtë:

1. Zj. D.Xh në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Për arsye se:

Në objektin “*Punime me ujësjellësin e Komunës Vllahinë*”, rezultuan volume punë të pakryera në vlerën **3,868,615 lekë pa T.V.SH** si dhe mangësi në dokumentacion si më poshtë:

- Mungon projekti teknik i zbatimit të punimeve dhe specifikimet teknike;
- Mungon plan – organizimi i punimeve të ndërtimit;
- Mungon libri i kantierit;
- Mungon dokumentacioni fotografik i mbajtur gjatë zbatimit të punimeve;
- Mungojnë provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si: hekur, beton etj.;
- Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse.
- Punimet për “*Depon e ujit 120 m³*” ishin jo efektive. Punimet janë marrë në dorëzim pa u mbyllur të gjitha proceset e punës të lidhura me këtë pjesë të investimit, dhe aktualisht kjo depo nuk është vënë në funksion të komunitetit;
- Punimet për tre rrethimet e bëra, konkretisht për Depon e ujit në fshatin Vllahinë, Depon e ujit në fshatin Kocul dhe Stacionin e pompave në fshatin Peshëkpi, janë marrë në dorëzim edhe pse nuk është kryer asnjë proces pune lidhur me këto pjesë të investimit;
- Në punimet për Riparimin e rrjetit shpërndarës në fshatin Kocul, tubi ϕ 75 mm, rezultoi se ishte i pambuluar me çakëll dhe rërë siç përshkruhet në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në kontratën individuale të punës, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i kemi rekomanduar Kryetarit të Komunës Vllahinë, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

D.1. “Vërejtje me paralajmërim”, duke gjykuar në bazë të përgjegjësisë rast mbas rasti, për punonjësit si më poshtë:

1. zj. L.Gj me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike

Për arsye se:

- Nuk ka zbatuar procedurat lidhur me përgatitjen dhe hartimin e projekt buxheteve, në përmbushje të të gjithë funksioneve, ku të sigurohet një evidentim i saktë, vlerësim dhe zbatim i njëjtë i buxhetit vendor dhe atij qendror, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e vitit 2013”, ligjin nr. 185/2013 “Për Buxhetin e vitit 2014”, për arsye se: në programimin e shpenzimeve për vitin ushtrimor, nuk janë përfshirë detyrimet afatshkurtra ndaj të tretëve, të rezultuara nga mbyllja e vitit të mëparshëm, veprim në kundërshtim me paragrafin 101, të Udhëzimit nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
- Ka paguar dy punonjës me pagë më të lartë se përcaktimi në pikat 18, 19 dhe 20/6, të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik **me vlerë 216,000 lekë**.

- Ka paguar pagat e punonjësve për vitin 2013 dhe 2014 nga artikulli 602 në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, pasi pagat paguhen nga artikulli 600, në të cilin llogaritet kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi. Njëkohësisht, konstatohet se niveli i pagës së punonjësve është nën nivelin minimal të kufijve të pagës së përcaktuar në VKM, Nr. 573, datë 03.07.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar.

-Nuk ka saktësuar sipas analizave aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, në mbështetje të inventarizimit fizik në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave.

- Nuk ka parashikuar likuidimin e investimeve të kryera dhe të marra në dorëzim, si dhe likuidimin e shpenzimeve operative të prapambetura, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM “Për zbatimin e buxhetit të viteve 2013-2014”.

- Nuk ka marrë masa për arkëtimin e debitorëve dhe për rillogaritjen e planit të ardhurave, pasi është konstatuar se ka rezerva në planifikim dhe ta paraqesë për miratim në Këshillin e Komunës, konform ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore”.

- Nuk ka krijuar regjistrin e aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nuk ka regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, objektet të regjistruara në postin “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara” në zbatim të ligjit nr.33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

-Nuk ka mbajtur librat e kontabilitetit si: ditari i arkës, bankës, magazinës, libri i magazinës dhe libri i madh, për të verifikuar saktësinë e tepricave të llogarive të pasqyruara në bilancin ose llogarinë vjetore të vitit ushtrimor 2013.

- Nuk ka regjistruar në librat e kontabilitetit dhe në pasqyrat financiare të vitit 2013, 2014, familjet debitor të fshatrave Vllahinë, Peshkëpi dhe Kocul, të cilat nuk kanë paguar ujin e pijshëm në **shumën 5,024,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Nuk ka arkëtuar vlerën totale 702,000 lekë, e përlllogaritur për 117 familje x 500 lekë x 12 muaj, me një diferencë më pak në vlerën 376,500 lekë, në kundërshtim me vendimin e këshillit të komunës nr. 2, datë 17.01.2013 “Për miratimin e taksave e tarifave të shërbimit në komunën Vllahinë për vitin 2013”.

-Nuk ka dokumentuar detyrimin për ujin e pijshëm në vlerën 376,500 lekë në dokumentet kontabël të vitit 2013, në kundërshtim me ligjin mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

-Nuk ka arkëtuar vlera totale, sipas listave bashkëlidhur në vlerën 1,152,000 lekë, e përlllogaritur për 192 familje x 500 lekë x 12 muaj, me një diferencë në vlerën 668,500 lekë, në kundërshtim me vendimin e këshillit të komunës nr. 2, datë 17.01.2013 “Për miratimin e taksave e tarifave të shërbimit në komunën Vllahinë për vitin 2013”.

-Nuk ka dokumentuar detyrimin për ujin e pijshëm në vlerën 668,500 lekë, në dokumentet kontabël të vitit 2013, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”.

-Nuk ka arkëtuar vlerën totale sipas listave bashkëlidhur në vlerën 1,164,000 lekë, e përlllogaritur 194 familje x 500 lekë x 12 muaj, me një diferencë më pak në vlerën 778,000 lekë, në kundërshtim me vendimin e këshillit të komunës nr. 2, datë 17.01.2013 “Për miratimin e taksave e tarifave të shërbimit në komunën Vllahinë për vitin 2013”.

-Nuk ka dokumentuar detyrimin për ujin e pijshëm në vlerën 778,000 lekë në dokumentet kontabël të vitit 2013, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”.

-Nuk ka arkëtuar vlerën totale sipas listave bashkëlidhur në vlerën 1,158,000 lekë, e përlllogaritur 193 familjeje x 500 lekë x 12 muaj, me një diferencë në vlerën 774,500 lekë, në

kundërshtim me vendimin e këshillit të komunës nr. 2, datë 10.02.2014 “Për miratimin e taksave e tarifave të shërbimit në komunën Vllahinë për vitin 2014”.

-Nuk ka dokumentuar detyrimin për ujin e pijshëm në vlerën 774,500 lekë në dokumentet kontabël të vitit 2014, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

-Nuk ka arkëtuar, detyrimet e banorëve të fshatit Peshkëpi, në vlerë totale sipas listave bashkëlidhur 702,000 lekë, e përlllogaritur për 117 familjeje x 500 lekë x 12 muaj, me një diferencë në vlerën 411,000 lekë, në kundërshtim me vendimin e këshillit të komunës nr. 2, datë 10.02.2014 “Për miratimin e taksave e tarifave të shërbimit në komunën Vllahinë për vitin 2014”.

-Nuk ka dokumentuar detyrimin për ujin e pijshëm në vlerën 411, 000 lekë, në dokumentet kontabël të vitit 2014, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”.

-Nuk ka arkëtuar vlerën totale sipas listave bashkëlidhur në vlerën 1,164,000 lekë, e përlllogaritur për 194 familje x 500 lekë x 12 muaj, me një diferencë në vlerën 912,500 lekë, në kundërshtim me vendimin e këshillit të komunës nr. 2, datë 10.02.2014 “Për miratimin e taksave e tarifave të shërbimit në komunën Vllahinë për vitin 2014” .

2. z. S.H, me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave;

3. z. L.Ç, me detyrë Inspektor Taksa Toke -Bujqësore, Shtëpi Banimi, Taksa –Tarifa,;

4. znj. D.M, me detyrë Inspektore Biznesi Vogël, Biznesi Madh, Transporti, Magaziniere;

5. znj. Z.M, me detyrë Inspektore Biznesi Vogël, Biznesi Madh, Transporti, Magaziniere.

6. z. P.Gj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës, Menaxhimit të Tokës dhe Shërbimeve;

Për arsye se:

-Nuk kanë dërguar zyrtarisht ne subjektet me T.V.SH, të biznesit të vogël dhe institucioneve brenda muajit Mars të çdo viti, njoftim detyrimet për taksa e tarifa dhe në Korrik –Gusht për ata që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë.

-Nuk kanë bashkëpunuar me Policinë komunale, për evidentimin e subjekteve të pa regjistruara, si dhe nuk kanë propozuar marrjen e masave sipas ligjit.

-Nuk kanë kryer kontrole në subjektet e biznesit të vogël për mbajtjen e dokumentacionit si libri i blerjeve, libri i shitjeve dhe dokumentet e shitjes si fatura të thjeshta tatimore dhe dëftesa tatimore dhe regjistrimin e tyre në librin e qarkullimit (xhiros).

-Nuk kanë ushtruar kontrole (sondazhe për matjen e xhiros) tek taksapaguesit, me qëllim vlerësimin e qarkullimit të realizuar nga taksapaguesi nëpërmjet kronometrit.

-Nuk kanë lidhur kontrata me çdo person që tregton në tregun e lirë, për taksën e zënies së hapësirave publike.

-Nuk kanë hartuar Regjistrin e përkohshëm për subjektet e paregjistruara.

-Nuk kanë nxjerrë regjistrimet e bëra nga të dhënat e Q.K.R-se

-Nuk kanë mbajtur dokumentacionin e nevojshëm në dosje të veçanta për secilin subjekt.

-Niveli i realizimit të të ardhurave nga administrata tatimore është shumë i ulët, konkretisht:

Në vitin 2013, ato janë realizuar në nivelin 32 % të planit vjetor, ose 28,842,204 lekë më pak nga shuma e të ardhurave të planifikuara. Ndërsa në vitin 2014, ato janë realizuar në nivelin 38% të planit vjetor, ose 26,931,977 lekë më pak nga shuma e të ardhurave të planifikuara.

Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe MPVD nr. 5, datë 27.01.2003 dhe udhëzimit të MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore” dhe Rregulloren e Brendshme “Për organizimin, funksionimin e administratës së Komunës Vllahinë” .

D.2. Masë disiplinore “Vërejtje”

1. z. A.H, me detyrë Ekonomist i pagave.

Për arsye se:

- Ka paguar dy punonjës me pagë më të lartë se përcaktimi në pikat 18, 19 dhe 20/6, të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 216,000 lekë.**

2. z. Z.A, me detyrë agronom,
3. z. N.A, me detyrë Inspektor Pyjesh,
4. z. S.Xh, me detyrë Inspektor Pyjesh,
5. z. A.S, me detyrë Inspektor Pyjesh,
6. z.N.N, me detyrë Inspektor Pyjesh,
7. z. M.B, me detyrë Inspektor Pyjesh,
8. z. A.R, me detyrë Inspektor Pyjesh.

Për arsye se:

-Nuk kanë zbatuar procedurat e aplikimit për regjistrimin në ZVRPP Vlorë, të pasurive dhe pronave të transferuara me VKM nr. 562, datë 07.08.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Komuna Vllahinë të Qarkut të Vlorë” dhe VKM Nr. 325, datë 16.5.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Vllahinë, të qarkut të Vlorës”, në zbatim të kreut IV neni 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, neni 18 Dokumentacioni i transferimit, dhe me pikat 1, 2 të nenit 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, për rrjedhojë nuk janë pasqyruar në kontabilitet në përputhje me: Kreun II Neni pikat 1-2 Kreu III neni 12, neni 18 pika 1 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe Pjesën I, pikat 2, 5, 6, 7, 8, 9 a, b, c, pikat 10, 12, 13. Pjesa III, pikat 26, 28. Pjesa IV, pikat 73, 74,75 Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nuk kanë marrë me procesverbal sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor të transferuar në zbatim të VKM nr. 562, datë 07.08.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Vllahinë, të Qarkut të Vlorë”, nuk janë përcaktuar kategoritë dhe mungojnë hartat përkatëse, ku të përcaktohen kufijtë dhe plan vendosjet e tyre.

- Nuk kanë vënë në efencë resurset si: dhënia me qira e pyjeve, kullotave dhe livadheve, apo lëndë punimi a material drusor tjetër për përdorim a shitje për nevoja të komunitetit si dhe të ardhura të realizuara nga përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, ku del se janë realizuar të ardhura minimale. *Në vitin 2013, nga 886 ha kullota janë dhënë me qira 181 ha ose 20% e sipërfaqes, me impakt financiar negativ në të ardhurat e komunës, për arsye se nuk është dhënë me qira 80% e sipërfaqes në pronësi. Ndërsa në vitin 2014, nga 886 ha kullota janë dhënë me qira 24 ha ose 3% e sipërfaqes, me impakt financiar negativ në të ardhurat e komunës, për arsye se nuk janë dhënë me qira 97% e sipërfaqes në pronësi.*

9. z. B.N, me detyrë Inspektor i IMKT.

Për arsye se:

- Nuk ka përgatitur program pune vjetor dhe programet e punës mujore
 - Nuk ka kontrolluar zbatimin e ligjshmërisë në zbatimin e detyrave të përcaktuara në dispozitat e mësipërme
 - Nuk ka ushtruar kontrolle periodike të territorit të komunës, duke sjellë mos evidentim koherent të zhvillimeve në fushën e ndërtimit brenda territorit të komunës
 - Nuk ka mbajtur regjistrin e kundravajtjeve administrative në fushën e ndërtimeve dhe të urbanistikës
 - Nuk ka përgatitur relacione, të dhëna dhe raporte për Kryetarin e komunës, as gjatë periudhës që ka qenë në detyrë as në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
- Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe në VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar dhe Rregullores së brendshme të Komunës Vllahinë.

10. z. D.M, me detyrë punonjës policie në komuna Vllahinë,

11. z. K.L, me detyrë punonjës policie në komuna Vllahinë.

Për arsye se:

- Nuk kanë programe vjetore, por vetëm mujore të miratuar nga Kryetari i Komunës për punën e Policisë së Komunës.

- Nuk kanë plan operativ të përbashkët me Sektorin e Tatim Taksave për organizimin e vjeljes së të ardhurave të komunës dhe me strukturat e tjera.
- Nuk kanë mbajtur asnjë procesverbal apo dokument tjetër për evidentimin e subjekteve pa leje apo mos pagesën e detyrimeve fiskale, duke mos justifikuar punën e tyre.
- Nuk kanë shkëmbim informacioni zyrtar nëpërmjet zyrës së protokollit, ndërmjet Policisë së Komunës dhe Sektorit të Tatim Taksave.

Nga komuna Vllahinë, me shkresë, protokolluar në KLSH me nr. 242/7, prot, datë 23.07.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Genc Koka, Jonild Hoxhaj, Julian Adili, Irma Shkupi, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT